

Ap – Kž – 323/2010
24 gusht 2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Martti Harsia si kryetar i kolegit, gjyqtarëve të EULEX-it Charles Smith dhe Lars Dahlstedt dhe gjyqtaret e Gjykatës Supreme Emine Mustafa dhe Marije Ademi si anëtarë të kolegit,

Në lëndën penale kundër të pandehurit A [] H [] i dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për dy pika Vrasje e rëndë në tentativë në bashkëkryerje [neni 147 paragrafi 1 pika 4 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK)] dhe Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve [neni 328 paragrafi 2 i KPK-së] sepse më 28 shkurt 2007 dhe 12 prill 2007, ai kishte shtënë në drejtim të veturës me të cilën udhëtonte A [] B [] me qëllim që ta privoj ngajeta. Duke vepruar në këtë mënyrë ai ka pasur në posedim dhe kishte përdorur një pushkë automatike dhe një raketahdhës,

Kundër të pandehurit M [] Q [] i dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për dy pika Vrasje e rëndë në tentativë në bashkëkryerje [neni 147 paragrafi 1 pika 4 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK)] dhe Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve [neni 328 paragrafi 2 i KPK-së] sepse më 28 shkurt 2007 dhe 12 prill 2007, ai kishte shtënë në drejtim të veturës me të cilën udhëtonte A [] B [] me qëllim që ta privoj ngajeta. Duke vepruar në këtë mënyrë ai ka pasur në posedim dhe kishte përdorur një pistoletë TT dhe një raketahdhës. Përveç kësaj, ai kishte në posedim dy pushkë automatike,

Kundër të pandehurit D [] S [] i dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për një pikë Vrasje e rëndë në tentativë në bashkëkryerje [neni 147 paragrafi 1 pika 4 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK)] dhe Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve [neni 328 paragrafi 2 i KPK-së] sepse më 12 prill 2007, ai kishte shtënë në drejtim të veturës me të cilën udhëtonte A [] B [], me qëllim që ta privoj ngajeta. Duke vepruar në këtë mënyrë ai ka pasur në posedim dhe kishte përdorur një granatë dorës. Përveç kësaj, ai kishte në posedim dy granata të dorës,

Të pandehurit H [] dhe Q [] kanë vepruar në bashkëpunim me qëllim që ta privojnë Berishën ngajeta. Më 12 prill 2007, i pandehuri Spahiu i është bashkangjitur Hotit dhe Qelës në aktivitetin e tyre.

Duke vepruar lidhur me ankesën e të pandehurve përmes avokatëve të tyre mbrojtës Mahmut Halimit më 31 gusht 2010 dhe Bekim Veliqit më 16 gusht 2010, Haxhi Cekaj më 24 gusht 2010, dhe përfundimisht të D [] S [] personalisht më 24 gusht 2010 dhe përmes avokatit të tij mbrojtës Hasan Jasharit më 17 gusht 2010 respektivisht, kundër aktgjykit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P.nr. 429/2007, të datës

20.11.2009, me anë të cilit Gjykata e Qarkut i ka shpallur të pandehurit fajtorë dhe i ka dënuar me burgim.

Pas mbajtjes së seancës më 23 gusht 2011 të hapur për publikun, në prani të Prokurores së Shtetit Gabriele Walentich, të pandehurve, avokatëve mbrojtës Mahmut Halimi, Haxhi Cekaj dhe Hasan Jashari, dhe pas këshillimit dhe votimit të mbajtur në të njëjtën ditë,

Më 24 gusht 2011, shpall këtë

AKTGJYKIM

A [REDAKTUE] me nofkë [REDAKTUE], emri i babait [REDAKTUE], emri i nënës dhe mbiemri i vajzërisë së nënës [REDAKTUE] vendi i lindjes dhe vendbanimi i fundit fshati Polac në Skenderaj, data e lindjes [REDAKTUE] tetor 19[REDAKTUE], Kosovar, student, i pamartuar, nuk ka fëmijë, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, në paraburgim dhe arrest shtëpiak që prej datës 12 prill 2007,

M [REDAKTUE] Q [REDAKTUE] nuk ka nofkë, emri i babait [REDAKTUE] emri i nënës dhe mbiemri i vajzërisë së nënës [REDAKTUE] vendi i lindjes fshati Jablanicë në Gjakovë, vendbanimi i fundit në Prishtinë, data e lindjes [REDAKTUE] Kosovar, student, i pamartuar, nuk ka fëmijë, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të dobët ekonomike, në paraburgim dhe arrest shtëpiak që prej datës 12 prill 2007,

D [REDAKTUE] S [REDAKTUE] nuk ka nofkë, emri i babait [REDAKTUE] emri i nënës dhe mbiemri i vajzërisë së nënës [REDAKTUE] vendi i lindjes Mitrovicë, vendbanimi i fundit në Pejton, Prishtinë, data e lindjes [REDAKTUE] Kosovar, punëtor, i pamartuar, nuk ka fëmijë, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të dobët ekonomike, në paraburgim dhe arrest shtëpiak që prej datës 12 prill 2007,

Ankesat e paraqitura në emër të të pandehurve kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P.nr. 429/2007, të datës 20 nëntor 2009 pranohen pjesërisht.
Dënim i ndryshohet si në vijim:

Për A [REDAKTUE] H [REDAKTUE] dëndimi për pikën e parë (vrasje e rëndë në tentativë më 28.2.2007) është 10 vjet, për pikën e dytë (vrasje e rëndë në tentativë më 12.4.2007) 11 vjet dhe për pikën e tretë (Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve) 1 vit. Dëndimi unik është 14 vjet.

Për M [REDAKTUE] Q [REDAKTUE] dëndimi për pikën e parë (vrasje e rëndë në tentativë më 28.2.2007) është 10 vjet, për pikën e dytë (vrasje e rëndë në tentativë më 12.4.2007) 13 vjet dhe për pikën e tretë (Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve) 1 vit. Dëndimi unik është 15 vjet.

Për D [REDAKTUE] S [REDAKTUE] dëndimi për pikën e dytë (vrasje e rëndë në tentativë më 12.4.2007) është 11 vjet dhe për pikën e tretë (Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve) 6 muaj. Dëndimi unik është 11 vjet e 4 muaj.

Pjesa tjeter e Aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë vërtetohet.

ARSYETIM

I HISTORIA PROCEDURALE

Prokurori i Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzën ndaj të pandehurve më datën 31 korrik 2007. H. [REDACTED] dhe Q. [REDACTED] janë akuzuar për dy pika të veprës penale të Vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerje [Neni 147 parografi 1 pika 4 lidhur me Nenin 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK)] si dhe për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve [Neni 328 parografi 2 i KPK-së] ndërsa S. [REDACTED] është akuzuar për Vrasje të rëndë në tentativë në bashkëkryerje [Neni 147 parografi 1 pika 4 lidhur me Neni 20 and 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK)] dhe për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve [Neni 328 parografi 2 i KPK-së]. Kjo aktakuzë është konfirmuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës më datën 17 shtator 2007.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 22 prill 2008 por është shtyrë për datën 15 maj 2008 dhe më vonë për 29 maj, 24 qershor, 11 shtator, 8 tetor dhe 18 nëntor 2008.

Më 2 qershor 2009, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka nxjerrë vendimin mbi caktimin e kësaj lënde për gjyqtarët e EULEX-it.

Shqyrtimi gjyqësor ka rifilluar dhe është mbajtur gjatë muajve tetor, nëntor të vitit 2009. Më 20 nëntor 2009 është shpallur aktgjykimi me të cilin Gjykata e Qarkut të Prishtinës ka shpallur fajtorë të pandehurit dhe ka dënuar A. [REDACTED] H. [REDACTED] me një dënim unik prej 16 vjetësh burgim, M. [REDACTED] Q. [REDACTED] me 20 vjet, ndërsa të pandehurin D. [REDACTED] S. [REDACTED] me 15 vjet e 6 muaj burgim.

Aktgjykimi i është dorëzuar personalisht të pandehurit A. [REDACTED] H. [REDACTED] në Qendrën e paraburgimit në Dubravë më 16 gusht 2010. Avokati mbrojtës Halimi ka paraqitur ankesë ndaj aktgjykimit të gjykatës së qarkut më 31 gusht 2010, ndërsa avokati mbrojtës Veliqi më 16 gusht 2010.

Aktgjykimi i është dorëzuar personalisht të pandehurit M. [REDACTED] Q. [REDACTED] në Qendrën e paraburgimit në Dubravë më 13 gusht 2010. Avokati mbrojtës Cekaj ka paraqitur ankesë ndaj aktgjykimit të gjykatës së qarkut më 24 gusht 2010.

Aktgjykimi i është dorëzuar personalisht të pandehurit D. [REDACTED] S. [REDACTED] në Qendrën e paraburgimit në Dubravë më 13 gusht 2010. Avokati mbrojtës Hasan Jashari ka paraqitur ankesë ndaj aktgjykimit të gjykatës së qarkut më 17 gusht 2010, ndërsa personalisht i pandehuri më 24 gusht 2010.

Më 25 shkurt 2011, Gjykata Supreme ka pranuar mendimin e Prokurorit të Shtetit, ndërsa Prokurori nuk ka paraqitur përgjigje.

II ANKESAT DHE PËRGJIGJA E PROKURORISË

1. Ankesat e A[REDACTED]H[REDACTED]

Avokati mbrojtës Mahmut Halimi i propozon Gjykatës Supeme ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së parë duke e liruar Hotin nga pika 1 e aktakuzës (Vrasje e rëndë në tentativë) për shkak të mungesës së provave dhe shqiptimin e një dënimisë më të lehtë për pikat 2 dhe 3 (Vrasje e rëndë në tentativë dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve), duke mos i propozuar Gjykatës Supreme prishjen e aktgjykimit dhe kthimin e lëndës për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Arsyet e prezantuara në ankesë përmblidhen si më poshtë:

Së pari, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) janë shkelur në mënyrë substanciale ngase aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme. Po ashtu, Aktgjykimi mbështetet në radhë të parë në dëshmitë e dhëna në stacionin policor të cilat janë të kundërtë me dëshmitë e dhëna në shqyrtimin gjyqësor. Këto dëshmi janë nxjerrë me forcë. Prania e avokatëve mbrojtës gjatë fazës së mëvonshme kur janë nënshkruar dëshmitë, nuk i korrigon këto dëshmi të marra me forcë. Sipas Nenit 235 të KPPK-së, dëshmitë e tillë janë të papranueshme. Për më tepër, identifikimi i të pandehurve i cili u krye nga J[REDACTED] K[REDACTED] dhe nga J[REDACTED] M[REDACTED] ka shkelur Nenin 255 të KPPK-së. Parimi i vlerësimit të lirë të provave i përshkruar në Nenin 152, paragrafin 2 nuk përfshin edhe provat e papranueshme. Gjykata është e obliguar ta respektojë parimin "in dubio pro reo" (që do të thotë në rast të dyshimit kjo gjë interpretohet në favor të të akuzuarit) siç përcaktohet në konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe po ashtu edhe në Kushtetutën e Kosovës dhe në Nenin 3, paragrafin 2 të KPPK-së. Gjithashtu, arsyet lidhur me pikën e parë të vrasjes së rëndë në tentativë janë kontradiktore dhe të pamjaftueshme. Për më tepër, Gjykata nuk ka zbatuar dispozitën përkatëse të kodit të procedurës penale apo e ka zbatuar gabimisht gjatë procedurës penale (Neni 403, paragrafi 2, pika 1).

Së dyti, gjendja faktike është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar lidhur me pikën e parë të vrasjes së rëndë në tentativë. Arsyetimi nuk përmend nëse janë gjetur gjurmë apo prova materiale siç janë gëzhojat në vendin e krimtit. I tërë sulmi ka mundësi të jetë trilluar me qëllim të largimit të vëmendjes nga akuzat kundër A[REDACTED] B[REDACTED]. Më tej, procedura e identifikimit nuk është bërë sipas Nenit 255 të KPPK-së dhe identifikimet janë të pabaza dhe të papranueshme. Po ashtu, Gjykata ka bërë vlerësim të gabuar të provave kur ka konstatuar se dëshmitë e dhëna para policisë si dhe dëshmja e J[REDACTED] K[REDACTED] e dhënë në zyrën e prokurorit kanë qenë më të besueshme sesa dokumentacioni mjekësor dhe se dëshmitë e Hotit të dhëna në zyrën e prokurorit dhe në gjykatë.

Së treti, ligji penal është shkelur ngase Gjykata nuk ka urdhëruar ekzaminimin neuropsikiatrik me qëllim të konstatimit nëse ekzistojnë arsyet e tjera për të përjashtuar

përgjegjësinë penale edhe pse ka pasur dyshime të bazuara. Këto dyshime mbështeten në raportin e mjekut ligjor Mazrek Gasior, të datës 5 korrik 2010 dhe në përshtypjet e kryetarit të kolegjit të theksuara në aktvendimin e datës 15 korrik 2010.

Së fundmi, dënimet janë tepër të ashpra. Aktgjykimi nuk jep asnje arsyesh me rrëthanat lehtësuese apo ato rënduese. Për shkak se A [REDAKTUE] B [REDAKTUE] dhe automjeti i tij kanë qenë objektiva të sulmit, prania e S [REDAKTUE] e M [REDAKTUE] dhe e M [REDAKTUE] në automjetin tjeter nuk mund të merret për bazë gjatë vlerësimit të dënimit. Pasojat e këtij sulmi kanë qenë lëndimet trupore të I [REDAKTUE] G [REDAKTUE] dhe dëmi material. H [REDAKTUE] kurrë nuk është gjykuar më parë për ndonjë vepër, pastaj i njëjtë ka pranuar veprat për të cilat ka qenë fajtor dhe është i varfér dhe shëndetlig me një moshë relativisht të re.

Avokati mbrojtës Bekim Veliqi propozon që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të anulohet dhe lënda të kthehet për rigjykim, ose që aktgjykimi të ndryshohet.

Së pari, ka pasur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Arsyetimi i këtij Aktgjykimi është i paqartë. Lidhur me faktet vendimtare të aktgjykimit janë disa kontradikta të mëdha në mes të asaj që thuhet në Aktgjykim dhe dëshmive e po ashtu edhe procesverbalit. Më pas, Aktgjykimi mbështetet në prova të papranueshme, në veçanti lidhur me pikën e parë të vrasjes së rëndë në tentativë. Po ashtu, provat e ofruara nuk mbështesin veprën e përshkruar në aktakuzë. Për më tepër, aktakuza mbështetet në tërësi në dëshmitë e dhëna në stacionin policor më datën 12.4.2007. Këto dëshmi janë marrë pa praninë e avokatit mbrojtës dhe vetëm janë nënshkruar në praninë e tij. Për këtë arsy, janë prova të papranueshme. Po ashtu, Neni 3, paragrafi 2 i KPPK-së si dhe parimi "In dubio, pro reo" është shkelur kur aktgjykimi thekson se hetimet nuk kanë sjellë asnje rezultat që vlen të përmendet. Më tej, i pandehuri i është nënshtruar dhunës, torturës dhe presionit psikologjik dhe fizik kur i është marrë dëshmia më datën 13.4.2007. Për më tepër, identifikimi i të dyshuarve nuk është bërë në pajtim me Nenin 255, paragrin 1 dhe 2 të KPPK-së, për arsy se këtij identifikimi i mungon përshkrimi i personit dhe për shkak se i njëjtë numër është shfrytëzuar për secilin person veç e veç në fotografi. Gjithashtu, përveç kësaj gjykata nuk ka sqaruar në mënyrë të quartë se cilat janë faktet të cilat ajo i konsideron të vërtetuara dhe për çfarë arsy i konsideron se ato fakte janë vërtetuar. Gjykata, gjithashtu, nuk e sqaron mënyrën se si e ka konstatuar përgjegjësinë penale në veçanti për veprën e parë të vrasjes së rëndë në tentativë. Krahas kësaj, gjykata po ashtu nuk ka bërë vlerësimin e të gjitha provave.

Së dyti, gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë. Arsyetimi i aktakuzës nuk mbështetet nga rapporti i policisë më 28.2.2007 sepse konstatimi i tyre është 'në rregull'. Gjithashtu, përshkrimi faktik është i bazuar në prova të papranueshme.

Së terti, nga shkeljet e përmendura më parë rezultojnë shkeljet e dispozitave të kodit penal. Më tej, gjykata nuk ka vlerësuar dashjen ose motivin për veprimet. Gjithashtu, nuk është provuar se më 28.2.2007 H [REDAKTUE] ka vepruar sikurse pohohet në aktakuzë dhe veprimet e tij më 12.4.2007 nuk përbushin përshkrimin e veprës penale.

Si pikë e katërt dhe e fundit, ankesa pretendon se sanksioni penal është tepër i rëndë

duke marrë parasysh për shembull, pasojat e veprës, shëndetin e të pandehurit, faktin se ai është duke u përballur me ligjin për herë të parë, pranimi i pjesshëm i fajësisë i tij dhe keqardhja e tij e thellë si edhe marrëdhëniet familjare të tij. Ka arsyе siç thuhet në nenin 66 të KPK-së për zbutjen e dënimit. Qëllimi i dënimit do të arrihet me një dënim më të vogël.

2. Ankesa e Q[REDACTED]

Në ankesë avokati mbrojtës H[REDACTED] C[REDACTED] propozon që Gjykata Supreme të anuloj aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dërgoi lëndën për rigjykim. Në mungesë që Gjykata Supreme duhet të ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë duke liruar Q[REDACTED] nga akuzat. Në çdo rast Gjykata Supreme duhet të ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë duke ulur dënimin për Q[REDACTED].

Arsyet e paraqitura për ankesë janë përmbledhur si më poshtë:

Së pari, dispozitat e procedurës penale janë shkelur në mënyrë të konsiderueshme. Aktgjyki eshtë konfuz, i paqartë dhe kundërthënës. Ai nuk deklaron në mënyrë të qartë përshkrimin faktik të H[REDACTED] se çfarë e konsideron të provuar. Gjithashtu, provat e paraqitura nuk vërtetojnë se veprimet e Q[REDACTED] përbëjnë krimet me të cilat ai është ngarkuar. Më tej, dispozitivi i aktgjykit ka tejkaluar aktakuzën. Për më tepër, nuk është bërë identifikimi sipas nenit 255 të KPPK dhe në mënyrë jo të sigurt dhe sikurse është bërë pas vrasjes së rëndë në tentativë të dytë që nuk lidhet me tentativën e parë. Gjithashtu, vlerësimi i provave është bërë në mënyrë përzgjedhëse ose të njëanshme - vetë-akuzimi, si edhe akuza kundër kryerësve janë pranuar, por jo deklarimi i pafajësisë për tentativën e parë. Prandaj parimi "*In dubio, pro reo*" nuk është respektuar. Më tej, dëshmitarja J[REDACTED] M[REDACTED] është dashur të dëgjohej në gjykim. Për më tepër, aktgjyki duhet të bazohet në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, por kjo nuk ka ndodhur në këtë lëndë. Së fundi, të drejtat e mbrojtjes janë shkelur për shkak se avokati mbrojtës nuk ishte i pranishëm gjatë gjithë intervistës në stacionin e policisë. Prandaj, kjo deklaratë është provë e papranueshme.

Së dyti, gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë. Asnjë gëzhojë nuk është marrë nga vendi i ngjarjes nga tentativa e vrasjes së rëndë të parë e as nuk është provuar se Q[REDACTED] ka prekur armë. Gjithashtu, për shkak të dëmtimeve të vogla të shkaktuara nga veprimet e tij elementet e krimtit me të cilat është i ngarkuar Q[REDACTED] me nuk janë plotësuar. Prandaj ai duhet të lirohet. E shtëna me një pistoletë nuk përbën vrasje të rëndë në tentativë por më tepër demonstrim i armës e jo më shumë se kjo. Më tej, deklarata e H[REDACTED] nuk është provë e besueshme, por ajo duhet të jetë mbështetura me prova materiale.

Së terti, dispozitat e Kodit Penal janë shkelur në mënyrë të konsiderueshme. Përgjegjësia penale e Q[REDACTED] nuk është vërtetuar me prova.

Si pikë e katërt dhe e fundit, ankesa pretendon se sanksioni penal është tepër i rëndë. Q[REDACTED] i dënimit është arritur me kohën e kaluar tashmë në paraburgim. Llogaritja e dënimit nuk është e bazuar në ligj. Vetëm rrëthanat rënduese janë marrë parasysh, por jo

rrethanat lehtësuese. Qela është një student gati për të diplomuar, ai nuk është përballur më parë me ligjin, ai është me gjendje të dobët ekonomik dhe ka pasur sjellje të mirë edhe gjatë procedurës.

3. Ankesa e S█████

Avokati mbrojtës Hasan Jashari propozon që Gjykata Supreme të anuloj aktgjykimin e shkallës së parë dhe kthimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Përndryshe avokati mbrojtës propozon që aktgjykim i shkallës së parë të ndryshohet.

Arsyet e paraqitura për ankesë janë përbledhur me sa vijon:

Së pari, dispozitat e procedurës penale janë shkelur në mënyrë të konsiderueshme. Arsyetimi i aktgjykit të është i paqartë për shkak se ka një kontradiktë në mes të dispozitivit dhe arsyetimit. Po ashtu, vendimi është bazuar kryesisht në deklaratat e dhëna në Polici. Këto deklarata janë marrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit. Më tej, aktgjyki nuk deklaron në mënyrë të qartë se cilat fakte i konsideron të provuar dhe pse. Për më tepër, provat nuk janë vlerësuar dhe analizuar në mënyrë të qartë e as përgjegjësia penale e S█████ nuk u shpjegua.

Së dyti, gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë. Shkeljet procedurale çojnë në vërtetimin e gabuar të fakteve. S█████ nuk e dinte që dy të pandehurit e tjerë ishin duke synuar të privojnë ngajeta A█████ B█████.

Së terti, dispozitat e Kodit Penal janë shkelur në mënyrë të konsiderueshme pasi që nuk është provuar se S█████ ka kryer veprën penale.

Si pikë e katërt dhe e fundit ankesa pretendon se sanksioni penal është tepër i rëndë. Rrethanat lehtësuese nuk janë marrë parasysh. Spahi nuk është përballur më parë ligjin. Pasojat e veprës janë minimale. Familja dhe arsyet personale të S█████ nuk janë marrë parasysh.

S█████ vet propozon që Gjykata Supreme të anuloj aktgjykimin e shkallës së parë dhe kthimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Përndryshe mbrojtësi propozon që ai duhet të jetë liruar nga akuzat.

Arsyet e paraqitura për ankesë janë përbledhur me sa vijon:

Së pari, dispozitat e procedurës penale janë shkelur në mënyrë të konsiderueshme. Dispozitiv për pikën e dytë të vrasje në tentativë ka tejkular aktakuzën. Gjithashtu, aktgjyki është i paqartë dhe i diskutueshëm dhe qartë deklaron veprimet e provuar të S█████ në lidhje me pikën e dytë të vrasjes në tentativë. Më tej, dashja nuk ekziston. Për më tepër, deklaratat e dhënë në stacionin e policisë janë prova të papranueshme, sepse të akuzuarit ishin marrë në pyetje pa avokatët e tyre ose pa i njoftuar për të drejtat e tyre.

Së dyti, gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë. Provat nuk mjaftojnë për të arritur në përfundimin se S. ka kryer vepra penale me të cilat ai akuzohet dhe pér këtë arsyje provat nuk i mbështesin akuzat. Asnjë nga dëshmitarët apo të pandehurit e tjerë nuk e implikojnë S. Gjithashtu, asnjë nga veprimet e tij të pretenduara nuk kanë pasur asnjë pasojë. Më tej, provat janë vlerësuar gabimisht. Pér më tepër, gjykata nuk deklaron se cilat veprime të S. i konsideron të provuar.

Së treti, dispozitat e Kodit Penal janë shkelur në mënyrë të dukshme.

Si pikë e katërt dhe e fundit ankesa pretendon se sanksioni penal është tepër i rëndë. Qëllimi i dënimit është arritur me kohën që S. ka kaluar tashmë në paraburgim. Gjithashtu, S. është relativisht i ri dhe nuk është përballur më parë me ligjin. Gjendja e tij financiare është e dobët.

4. Mendimi i Prokurorit Publik

Prokurori Publik ka propozuar të refuzohen ankesat si të pabazuar.

Prokurori Publik argumentoi se intervistat e policisë të kryer më 13 prill 2007 janë prova të pranueshme pasi asnjë nga kushtet e nenit 235 të KPPK që e bëjnë një deklaratë të papranueshme nuk janë përmbrushur. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka adresuar si duhet presionin e supozuar të panevojshëm dhe i refuzoi akuzat. Marrja në pyetje është bërë në respektim të plotë pér të gjitha të drejtat ligjore të të pandehurve dhe të gjithë të pandehurit kanë nënshkruar procesverbalin.

Aktgjykimi nuk e tejkalon qëllimin e akuzave pér S. ose Q. kështu që nuk ka shkelje të nenit 403 paragrafi 1 pika 10 të KPPK.

Nuk ka shkelje të nenit 403 paragrafi 10 pika 12 të KPPK. Dispozitiv përban të dhënat e kërkura në nenet 396 dhe 391 të KPPK. Kjo nuk është në kundërshtim me arsyetimin sikurse që edhe arsyetimi dhe faktet e konsideruara të provuara në arsyetim janë qartazi në përputhje me përbajtjen e dispozitivit. Kontradiktat me aktakuzën nuk bien në fushëveprimin e nenit 403 të KPPK. Duke marrë parasysh Q., Prokurori Publik vëren që në dispozitiv adresimet janë bërë pér të dy paragrafët 2 dhe 3, por aktakuza origjinale në gjuhën shqipe i referohet vetëm paragrafit 2.

Në procedurën nuk ka shkelje në përputhje me nenin 403 paragrafi 2 pika 1 të KPPK. Fajësia e S. ishte provuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Sipas nenit 153 të KPPK provat e marra gjatë hetimit janë të papranueshme vetëm nëse kjo është përcaktuar shprehimisht në ligj. KPPK nuk përcakton shkeljet e nenit 255 që bën provat të papranueshme. Prandaj rezultati i identifikimit nuk është prova të papranueshme. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë çështjen e identifikimit. Gjykata e shkallës së parë ka vepruar në përputhje me nenin 368 paragrafi 1 pika 1 në lidhje me deklaratën e J. M.

Nuk ka shkelje të ligjit penal në procedurë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar plotësisht qëllimin kriminal të të gjithë të pandehurve dhe shtjellon këtë vlerësim në aktgjykim. Prandaj nuk ka shkelje të nenit 15 të KPK-së. Avokati mbrojtësi i H. nuk ka kërkuar një ekzaminim neuropsikiatrik. Më tej, kryerja e krimeve dhe të planifikuarit dhe kryerja e tyre nuk tregojnë ekzistencën e ndonjë paaftësie mendore ose kapacitet të zvogëluar mendore. Prandaj, nuk ka shkelje të nenit 12 të KPK.

Gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht. Gjykata Supreme nuk vlerëson besueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve, por pajtohet me vlerësimin e trupit gjyques.

Gjykata e shkallës së parë drejtë i ka shqyrtuar rrethanat e veprës penale dhe të pranimit të fajësisë së H. kur e ka konsideruar dënimin. Dënimet e shqiptuara nuk janë jo proporcionale me peshën e krimit.

III GJETJET E GJYKATËS

A. Lejueshmëria e ankesës

Gjykata Supreme konstaton se ankesat janë paraqitura brenda afatit 15 ditor sikurse përshkruhet në nenin 398 të KPPK dhe ato në këtë mënyrë ishin në kohë dhe të lejueshme. Ankesat u paraqitën nga ana e avokatëve mbrojtës, personave të autorizuar, dhe personalisht nga i pandehuri Spahiu.

Kolegji tani do të vlerësojë secilin prej argumenteve të ngritura në ankesat e mbrojtjes.

B. Shkeljet e pretenduara të kodit të procedurës penale

Të tre të pandehurit pohojnë se deklaratat e të pandehurve të dhëna në stacionin e policisë më 13.4.2007 janë të papranueshme, sepse ata janë dëgjuar pa praninë e avokatëve të tyre dhe janë keqtrajtuar nga policia për tu detyruar që të pranojnë. S. gjithashtu pohon se të pandehurit nuk janë njoftuar për të drejtat e tyre.

Siqështë theksuar në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të tre të pandehurit i kanë dhënë dëshmitë e tyre para policisë në ditën pas arrestimit të tyre dhe në prani të avokatëve të tyre mbrojtës. Të dy të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës i kanë nënshkruar dëshmitë.¹ Gjykata Supreme thekson se dëshmitë e H. dëshmitë e Q. tregojnë se policia i ka dëgjuar që të dytë më 12.4.2007, pasi që të dy dëshmitë e përbajnë pyetjen "A pranoi si tuajën dëshminë e dhënë dje më 12.04.2007 në polici?". Sidoqoftë, këto dëshmi të datës 12.4.2007, nuk janë pjesë e shkresave të lëndës. Përbajtja e dëshmisë më 13.4.2007 e dhënë nga H. konfirmon praninë e avokatit mbrojtës në intervistë kur deklaron se "P: A mund të na thoni në prani të avokatit, atë që na e keni thënë dje në

¹ Faqe 11-12 e versionit në gjuhën angleze

lidhje me sulmet ndaj A. B.?".² Dëshmia e Q. përsërit pyetjen gati fjalë përfjalë. Përfundimi i vetëm i arsyeshëm është se e tërë intervista më 13.4.2007, më parë se vetëm nënshkrimet, është bërë në prani të avokatëve mbrojtës. Dëshmia e S. nuk përmban asnjë referencë lidhur me intervistën e mëhershme kështu që ekzistojnë edhe më pak arsyë të besohet se ai është dëgjuar pa praninë e avokatit të tij mbrojtës.

Dëshmitë e të gjithë të pandehurve theksojnë se ata kanë qenë të njoftuar për të drejtat e tyre.

Sa i përket pretendimit të keqtrajtimit nga ana e policisë për t'i detyruar që ta pranojnë, Gjykata Supreme thjesht i referohet argumenteve të Gjykatës së Qarkut. Gjykata e Qarkut në mënyrë të quartë dhe të shteruar ka argumentuar arsyet për hedhjen poshtë të pretendimit dhe Gjykata Supreme i pranon këto argumente plotësisht.³

Prandaj, dëshmitë janë të pranueshme.

Të tre të pandehurit gjithashtu kanë pohuar se dëshmitë e identifikimit të të pandehurve nga J. K. dhe J. M. janë të papranueshme sepse procedura e identifikimit nuk është bërë sipas KPPK-së.

Sic është theksuar në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut⁴ dëshmitarja M. nuk ka qenë në gjendje të marrë pjesë në gjykim për shkak të gjendjes së saj shëndetësore të dobët. Gjykata e Qarkut ka zbatuar në mënyrë të drejtë nenin 386 paragrafin 1 pikën 1 të KPPK-së dhe ka lexuar dëshminë e saj në procesverbal. Më tutje, sic diskutohet në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut⁵, nen 153 i KPPK-së përcakton se provat e marra në shkelje të procedurës penale do të jetë të papranueshme kur Kodi apo dispozitat e tjera të ligjit në mënyrë të quartë përcaktojnë një gjë të tillë. Kodi i Procedurës Penale nuk e përcakton në mënyrë të quartë mungesën e përshkrimit në procedurën e identifikimit e cila rezulton në papranueshmëri të atij identifikimi. Në këtë mënyrë, dëshmitë e identifikimit janë të pranueshme. Prandaj, Gjykata është e lirë pranoj dhe konsideroj si dhe vlerësojë lirshëm dëshmitë e identifikimit madje edhe nëse atyre iu mungon përshkrimi.

Sa i përket mungesës së ekzaminimit neuropsikiatrik, Gjykata Supreme vëren se sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pasur asnjë kërkesë për ekzaminim neuropsikiatrik. As nuk ka asgjë në shkresat e lëndës që do të ngritë dyshime sa i përket gjendjes mendore të të pandehurit. Vlen të përmendet se të dy dokumentet të cilave avokati mbrojtës Halimi i referohet mbajnë datën pas shpalljes së aktgjykimit më 20 nëntor 2010.

M. Q. dhe A. H. akuzohet për "dy vepra penale vrasje e rëndë në tentativë në kundërshtim të nenit 147 paragrat 1 pikave 4 dhe 7 në lidhje me nenit 20 dhe 23 të KPPK-së" dhe D. S. për "një vepër penale vrasje e rëndë në tentativë në kundërshtim të nenit 147 paragrat 1 pikave 4 dhe 7 në lidhje me nenit 20 dhe 23 të

² Prosesverbal i ekzaminimit të pandehurit H. më 13.4.2007

³ Faqe 12-13 e versionit në gjuhën angleze

⁴ Faqe 18-19 e versionit në gjuhën angleze

⁵ Faqe 17-18 e versionit në gjuhën angleze

KPPK-së". Të pandehurit A [REDACTED] H [REDACTED] dhe D [REDACTED] S [REDACTED] gjithashtu akuzohen për "Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së". M [REDACTED] Q [REDACTED] dhe S [REDACTED] gjithashtu akuzohen për "Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 3 të KPPK-së".⁶ Kjo aktakuzë është konfirmuar pa ndryshime. Prandaj, dispozitivi i aktgjykimit nuk e tejkalon aktakuzën.

C. Mungesa e pretenduar e përgjegjësisë penale

Qëllimi i të pandehurve argumentohet në mënyrë të qartë në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut.⁷ Gjykata Supreme e pranon këtë vlerësim. Prandaj, qëllimi është vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme dhe është vërtetuar në mënyrë të drejtë.

D. Mungesa e pretenduar e provave dhe vlerësimi i gabuar apo joadekuat i provave të prezantuara

KPPK-ja nuk kërkon administrimin një lloj specifik të provave para se një i akuzuar të shpallet fajtor. Përkundrazi, neni 152 paragrafi 2 i KPPK-së përcakton se "Gjykata, sipas vlerësimit të vet, mund të pranojë dhe të marrë parasysh çdo provë të pranueshme që ajo mendon se është e rëndësishme për procedurën penale konkrete dhe ka autoritetin të vlerësojë lirisht të gjitha provat e parashtuara me qëllim të përcaktimit të rëndësise ose papranueshmërisë së tyre."

Sa i përket vlerësimit të provave, Gjykata Supreme vëren se vlerësimi i hollësishëm i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut tregon se provat e prezantuara në shqyrtimin gjyqësor janë diskutuar në mënyrë të shteruar.

Gjykata e Qarkut ka marrë parasysh të gjitha provat dhe ka bërë vlerësimin e vet. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut nuk është i bazuar vetëm në dëshmitë e të pandehurve të dhëna në stacionin e policisë. Gjatë shqyrtimit të sulmit më 28 shkurt 2007, Gjykata e Qarkut i referohet deklaratës së dhënë nga A [REDACTED] H [REDACTED] stacionin e policisë më 13 prill 2007 në lidhje me atë çfarë ka deklaruar ai në shqyrtimin gjyqësor. Për më tepër, Gjykata e Qarkut ka marrë parasysh dëshmitë e palëve të dëmtuara J [REDACTED] he A [REDACTED] B [REDACTED] si dhe të J [REDACTED] M [REDACTED] Gjithashtu, Gjykata e Qarkut ka marrë parasysh raportin e policisë të datës 28.2.2007. Gjatë shqyrtimit të sulmit më 12 shkurt 2007, Gjykata e Qarkut i referohet dëshmive të palëve të dëmtuara A [REDACTED] B [REDACTED] si dhe anëtarëve të njësisë për mbrojtje nga afër të cilën e përcillnin në atë kohë, raportin mjekësor për I [REDACTED] G [REDACTED], informatat e prezantuara nga raporti i forenzikës, pranimi nga A [REDACTED] H [REDACTED] lidhur me atë çfarë ka deklaruar në shqyrtimin gjyqësor, dëshmitë e M [REDACTED] Q [REDACTED] si dhe E [REDACTED] S [REDACTED] lidhur me atë çfarë kanë deklaruar në shqyrtimin gjyqësor, pranimë e tre të akuzuarve afër vendit të krimtit si dhe posedimin e dy granatave të dorës nga D [REDACTED] S [REDACTED] si dhe gjurmët e gishtërinjve të tij në raketahdhës.

⁶ Aktakuza e datës 23.7.2007, faqet 2-3 e versionit në gjuhën angleze

⁷ Faqet 20-21 e versionit në gjuhën angleze

Që të dyja arsyetimi faktik dhe juridik tregohen në aktgjykim. Gjykata e Qarkut ka ofruar analizën e dënimit në lidhje me përshkrimin e veprimeve të të gjithë të pandehurve në lidhje me krimet për të cilat janë shpallur fajtorë. Kjo provë në mënyrë të qartë mbështet përfundimin e bërë nga Gjykata e Qarkut e mishëruar në dispozitiv e saj. Gjykata Supreme nuk është bindur nga pretendimet e ngritura në ankesa.

Gjithashtu, Gjykata Supreme vëren se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk do t'i shqyrtoj në përgjithësi vlerësimet e provave të gjyltatave kombëtare. Do të veprojë në këtë mënyrë vetëm nëse gjykata kombëtare ka bërë "përfundime arbitrale ose tepër të padrejta nga faktet e dorëzuara te ajo".⁸

E. Cilësimi juridik

KPK-ja nuk e përcakton vetëm dënimin për ata të cilët janë fajtorë dhe kanë shkaktuar dëme, por gjithashtu dënon edhe ata të cilët janë munduar të shkaktojnë dëme. Sipas nenit 20 të Kodit Penal të Kosovës "*Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale.*"

Në lëndën në fjalë të pandehurit kanë përfunduar veprimin e kryerjes së veprës penale; më 28 shkurt 2007, A. H. dhe M. Q. kanë shtënë me armë në drejtim veturës së A. B. dhe më 12 prill 2007, A. H. M. Q. dhe D. S. kanë shtënë nga raketahdhësi dhe kanë hedhë granatë të dorës. Gjykata e Qarkut në mënyrë të qartë ka argumentuar dashjen e të pandehurve. Dashja ka qenë të vritet B. Po të kishin pasur sukses të pandehurit cilësimi juridik i veprës penale pa dyshim do të ishte vrasje e rëndë. Prandaj, elementi kryesor i veprës penale të vrasjes që ishte si qëllim – privimi ngajeta e A. B. – nuk është përbushur dhe veprimet e të pandehurve bien nën fushëveprimin e tentativës siç përcaktohet në nenin e lartpërmendur.

F. Dënim

Në përputhje me nenin 64 paragafin 1 të KPK-së "*Gjykata e cakton dënimin për vepër penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë vepër penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrëthanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrëthanat lehtësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrëthanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrëthanat e tij personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënnimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrëthanat e kryerësit.*"

Pika e nisjes në caktimin e dënimit është kufiri i paraparë me ligj për atë vepër penale. Në përputhje me Nenin 147 të KPK-së parashev burgim me së paku dhjetë vjet apo burgim afatgjatë ai dënnimi për vrasje të rëndë. Neni 65 parografi 2 thotë se "*Dënnimi i shqiptuar*

⁸ Waldberg kundër Turqisë, Nr. 22909/93 (baza e të dhënave Hudoc)

për tentativë... nuk duhet të jetë më i lartë se tri të katërtat e maksimumit të dënimit të paraparë për vepër penale... “

Qëllimi i dënimit siç përcaktohet me Nenin 34 të KPK-së është “*Të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; dhe të përbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.*” Këto parime nuk ofrojnë ndonjë ndihmë të madhe në caktimin e kohëzgjatjes së burgimit për kryerësin.

Në caktimin e dënimit Gjykata e Qarkut mori parasysh si rrethana rënduese dhe lehtësuese numrin e viktimave të mundshme të vrasjeve në tentativë dhe shkallën e respektit për jetën e njjerit të shfaqur nga të pandehurit, fuqinë e armëve të përdorura veçanërisht më 12 prill 2007, vendosmërinë e të pandehurve për ta përfunduar veprën dhe mos pendimin apo mos të menduarit dy herë në mes sulmit të parë dhe të dytë (H. . . dhe Q. . .), cilësimin e veprës si tentativë, pranimin e pjesshëm të H. . . (pika 2) dhe përfshirja e rastit e S. . . (në kuptim të asaj se ai nuk mori pjesë në planifikim por iu bashkua A. . . H. . . dhe M. . . Q. . .). Gjykata Supreme në përgjithësi pajtohet me vlerësimin e faktorëve lehtësues dhe rëndues të bërë nga Gjykata e Qarkut.

Megjithatë, Gjykata Supreme më tutje specifikon arsyet për këtë dënim. Fraza “sidomos” e përdorur në Nenin 64 paragrafin 1 të KPK-së do të thotë se arsyet e shënuara këtu kanë rëndësi të veçantë. Sa i përket shkallës së përgjegjësisë penale Gjykata Supreme potencon se justifikimi i përgjithshëm i penalizmit të një tentative nuk është ndodhja e të keqes por parandalimi i saj. Neni 20 i KPK-së duket se sugeron se ekzistojnë dy lloje të tentativave – ato ku i pandehuri nuk ka përfunduar veprimin e kryerjes së veprës dhe ato ku elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar. Në lëndën në fjalë të pandehurit kryen veprimet dhe prandaj të pandehurit janë më fajtorë se po të kishin ndërprerë kryerjen e krimit në minutën e fundit. Incidenti përfundoi pa lëndime të askujt rastësishët e jo si alternativë, thjesht për shkak të fatit të A. . . B. . . Fajësia morale e të pandehurve në këtë rast nuk është më e vogël se sa të kishin pasur sukses në tentativën e tyre pasi që rezultati nuk kishte të bëjë fare me vullnetin e të pandehurve. Prandaj dënimini duhet të jetë më afër dënimit për kryerje të veprës penale.

Për më tepër, lidhur me motivet për kryerjen e veprës Gjykata Supreme vëren se aktakuza qartë pohon se A. . . H. . . dhe M. . . Q. . . shin angazhuar për të kryer veprën penale në këmbim të pagesës dhe prandaj ata kishin për qëllim përfitimin financiar.⁹ Të pandehurit megjithatë nuk ishin shpallur fajtorë në përputhje me Nenin 147 paragrafin 1 pikën 7 (me qëllim të fitimit të dobisë pasurore) e as ky motiv nuk interpretohet në përshkrimin e veprave penale në dispozitiv. Edhe pse trupi gjykues në arsyetimin e Aktgjykimit debatoi për ligësinë e arsyeve si rrethanë për krimin e rëndë¹⁰ nuk duket të jetë e nevojshme të ilustrohet më tutje. Trupi gjykues më tutje pohon se “*Gjyqtarët e kishin të qartë se tre të akuzuarit ... nuk ishin ata që i frymëzuan ata. Ata ishin vetëm mercenarë.*”¹¹ Trupi gjykues vazhdon me pohimin se të pandehurit “*treguan lojalitet ndaj atyre të cilët iu*

⁹ Aktakuza, faqe 2 e versionit në gjuhën angleze

¹⁰ Aktgjykim i datës 20 nëntor 2009, faqe 21 e versionit në gjuhën angleze

¹¹ Aktgjykim i datës 20 nëntor 2009, faqe 22 e versionit në gjuhën angleze

dhanë mandatin.”¹² Gjykata Supreme është e mendimit se për shkak se të pandehurit nuk janë shpallur fajtorë për veprim me qëllim të fitimit të dobisë pasurore motivet e tyre nuk mund të konsiderohen si faktorë rëndues në lidhje me dënimin.

Qëllimi i mbrojtjes ligjore i përcaktuar me Nenin 147 ështëjeta e personit tjetër. Gjykata e Qarkut ka diskutuar në mënyrë shteruese për intensitetin e rrezikimit apo dëmitimit të vlerës së mbrojtur të shkaktuar nga veprat penale. Megjithatë, nuk i ka diskutuar dëmtimet ekzistuese ndaj vlerës së mbrojtur kur është caktuar dënimini edhe pse ky është kriter i përcaktuar me Nenin 64 paragrafin 1 të KPK-së. Prandaj Gjykata Supreme thekson se, fatmirësisht, sulmet nuk rezultuan me pasoja më të rënda se sa lëndimi trupor i njërit person.

Gjykata e Qarkut nuk i ka diskutuar sjelljet e kaluara të të pandehurve kur ka caktuar dënimin edhe pse ky është kriter i përcaktuar me Nenin 64 paragrafin 1 të KPK-së. Po ashtu, në akt gjykimet e mëparshme¹³ Gjykata Supreme ka përfunduar se nëse nuk ka konflikt të mëparshëm me ligjin ky është një fakt lehtësues. Të tre të pandehurit pretendojnë se kjo është hera e parë që përballen me ligjin. Gjykata Supreme nuk është në dijeni për dënimë të mëparshme të asnjërit të pandehurit.

Gjykata e Qarkut nuk i ka diskutuar rrëthanat personale të kryerësit edhe pse ky është kriter i përcaktuar me Nenin 64 paragrafin 1 të KPK-së. Kjo është konfirmuar në akt gjykimet e mëparshme të Gjykatës Supreme.¹⁴ Raporti i ekzaminimit fizik të A[REDACTED] H[REDACTED] datës 5 korrik 2010 nga Marek Gasior arrin përfundimin se A[REDACTED] H[REDACTED] ka një të metë të vogël neurologjike në të dyja këmbët në pjesën e poshtme, pak më shumë në anën e majtë. M[REDACTED] Q[REDACTED] he D[REDACTED] S[REDACTED] kanë gjendje të dobët ekonomike.

Sa i përket sjelljes pas kryerjes së krimtit, Gjykata Supreme vëren se A[REDACTED] H[REDACTED] nuk ka pranuar pikën e parë të vrasjes në tentativë por vetëm të dytën. Prandaj zvogëlimi i dënitit bazuar në faktin lehtësues të pranimit të krimtit nuk vlen për pikën e parë të vrasjes në tentativë.

Së fundi, Neni 64 paragrafi 1 i KPK-së thotë se “*dënimini duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrëthanat e kryerësit.*” Gjykata Supreme është e mendimit se dënimet e shqiptuara nga Gjykata e Qarkut janë tepër të rënda. Prandaj Gjykata Supreme ka zvogëluar dënimet për të gjithë të pandehurit.

IV PËRFUNDIM

Gjykata Supreme gjen se ankesat janë pjesërisht të bazuara.

¹² Sikur më lart

¹³ Shin për shembull Ap. Kz. Nr. 180/2005 të datës 24.5.2005, Ap. Kz. Nr. 62/2005 të datës 21.4.2005 apo Ap. Kz. Nr. 401/2004 të datës 12.12.2004

¹⁴ Sikur më lart

Gjykata Supreme nuk njeh *ex officio* asnje shkelje te ligjit (nga Neni 415 paragrafi 1 i KPPK-së) që nuk ishin subjekt i ankesës nga ana e mbrojtjes.

Duke u bazuar në arsyet e përmendura më lart është vendosur sikur në dispozitiv.

**Sot më 24 gusht 2011.
Ap.-Kž. Nr. 323/2010**

Përgatitur në Gjuhën Angleze, gjuhë e autorizuar.

Kryetari i Kolegjit
Martti Harsia

Procesmbajtësja
Noora Aarnio

Anëtar i Kolegjit
Charles Smith, III

Anëtar i Kolegjit
Lars Dahlstedt

Anëtare e Kolegjit
Marije Ademi

Anëtare e Kolegjit
Emine Mustafa